




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-0/DPK
Nr. i faq broj stranica Nr. pages	03
Nr. Prot Br. Prot Prot. No	01-3381/13
Data Datum Date	17.10.2013
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	16/10/2013
REFERENC-Ë:	AKK - DPK
PËR/ZA/TO:	z. Fatmir GJONBALAJ Drejtor i Prokurimit-Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
CC:	z. Ejup QERIMI Drejtor -Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: "Furnizim me automjete"



Të nderuar!

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me tenderin "Furnizim me automjete", me nr. të prokurimit: PTK 13 051 111, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues, që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Furnizim me automjete", në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Zyra e Prokurimit e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës ka përgatitë “Njoftim Kontrate” me titullin: “Furnizim me automjete”, me nr. prokurimi: PTK 13 051 111, e cila është përgatitur më 21/08/2013, në Procedurë të Hapur. Ky aktivitet i prokurimit ishte e ndarë në 2 (dy) Lote. Bazuar në “Njoftim për Kontratë” të publikuar në KRPP më datë 20/08/2013, AKK ka kërkuar të jetë pjesë e monitorimit të vlerësimit të kësaj procedure prokurimi.

Dosjen e Tenderit në këtë procedurë prokurimi e kanë tërhequr 19 (nëntëmbëdhjetë) Operator Ekonomik, ndërsa kishin dorëzuar 3(tre) prej tyre.

Sipas raportit të vlerësimit, i vetmi Operator Ekonomik i përgjegjshëm në këtë procedurë prokurimi del të jetë “AGS”. Përkundër faktit se: Tek specifikimet teknike për lot.2 kërkohej reduktori i automjetit të jetë “High 2, High 4 dhe Low2” Operatori Ekonomi “AGS” kishte ofertuar me “High 2, High 4 dhe Low4”. Oferta e AGS mund të jetë më e favorshme për Autoritetin Kontraktues, andaj konsiderojmë se mund të mos ishte relevante.

Operatori Ekonomik DTBH ka qenë njëri nga tre OE që kanë ofertuar. DTBH është regjistruar në Kosovë dhe pronar i sajë është “Mak Auto Star” nga Shkupi. “MakAutoStar” ka lëshuar Autorizim nga prodhuesi MITSUBISHI për ofertuesin DTBH, por “MakAutoStar” gjithashtu i ka lëshuar autorizim edhe Operatorit Ekonomik “AGS” Pasi që Komisioni Vlerësues nuk ka gjetur ndonjë nen të caktuar në Ligjin e Prokurimit dhe Dosjen e Tenderit që ndalon një gjë të tillë, nuk mund të konsideronin pengesë për vlerësimin tutje.

Operatori Ekonomik “HYUNDAI” përkundër ofrimit të deklaratës së nënshkruar dhe të vulosur se i plotëson gjitha kriteret teknike dhe financiare për këtë tender, ka ofruar një Automjet me 2199 cm³ përkundër kërkesës minimale 2268 cm³ të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

Automjeti i ofruar nga “AGS” kishte fiks 2268 cm³ gjë që shton dyshimin, pse AK ka vënë këtë shifër aq specifike që e plotëson saktë prodhimin i MITSUBISHI-t.

DTBH nuk kishte plotësuar edhe “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale” ku kërkohej Lista nga OE me furnizime të ngjashme në periudhën 3 vjeçare. Shuma e kontratave të realizuara duhej të ishte së paku sa dyfishi i çmimit të ofertës së ofruar.

Autoriteti Kontraktues më datë 26/09/2013 ka Shpërblyer me Kontratë Operatorin Ekonomik “AGS” për 2(dy) Lotet. Lot.1 me çmim: 119.600.00 € dhe Lot.2 me çmim: 167.400.00 €. Në “Njoftim për Dhënie të Kontratës” të datës: 26/09/2013, pika IV.4 dhe IV.5 Informacioni mbi vlerën e Kontratës, çmimi më i ultë dhe çmimi më i lartë paraqiten me shifra të njëjta: Për Lot.1 çmimi më i ulët dhe më i lartë paraqitet 119.600.00 €, ndërsa për Lot.2 çmimi më i ulët dhe më i lartë paraqitet 167.400.00 €.

Komisioni i vlerësimit ishte i përbërë nga katër anëtar. Sipas vendimit të zyrtarit Kryesor të Prokurimit, i aprovuar nga Krye shefi Ekzekutiv, kryesuesi i komisionit, nuk ka të drejtë vote gjatë punës së komisionit.

Kjo procedurë prokurimi kishte vetëm një Operator Ekonomik të përgjegjshëm të cilin Autoriteti Kontraktues e ka shpërblyer me kontratë. Shpërblimi me Kontratë i Operatorit të vetëm Ekonomik të përgjegjshëm, bie ndesh me nenin 32.4 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042

Gjatë procesit të kësaj procedure, Autoriteti Kontraktues ishte bashkëpunues, përpos zvarritjeve në dokumentacion. Zvarritje e cila ka pamundësoi parandalimin e nënshkrimit të Kontratës. Përkundër kësaj, AKK do të merr hapa tjerë tek organet kompetente në përputhje me ligjet në fuqi.

AKK rekomandon që të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Me respekt!

